



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 627 prot

Korçë, më 27/03 / 2026

VENDIM

Nr. 149, datë 27.03.2026

PËR

MIRATIMIN E PYETËSORIT STUDENTOR 2026

Bazuar në Manualin e Cilësisë së Universitetit "Fan S. Noli", si dhe në Kodin e Cilësisë, VKM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë (standartet e cilësisë), Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.03.2026,


VENDOSI:

1. Të miratojë PyetëSORIN Studentor 2026, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





PYETËSOR STUDENTOR 2026



Këshilli Studentor dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizojnë pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2025-2026.

(Ngjyros rrethin për zgjedhjen tuaj ose jepni mendimin në pyetjet e mëposhtme)

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.

FAKULTETI

Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
(A)	(B)	(C)	(D)

CIKLI DHE PROGRAMI I STUDIMIT

Program profesional	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave
(A)	(B)	(C)	(D)

- *Specifiko programin e studimit* _____

ZGJIDH VITIN E STUDIMIT:

GJINIA

VITI I PARË	VITI I DYTË	VITI I TRETË	FEMËR	MASIKULL
(1)	(2)	(3)	(F)	(M)

2. VLERËSIMI I MATERIALEVE DHE TEKNOLOGJIVE MËSIMORE

Si do ta vlerësonit mjaftueshmërinë e materialeve mësimore të ofruara (tekste bazë, tekste ushtrimesh, literaturë ndihmëse).

E pamjaftueshme	Disi e mjaftueshme	Të mjaftueshme	Shumë e mjaftueshme	Tepër të mjaftueshme
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)

A mendoni se materialet mësimore (tekste bazë, tekste ushtrimesh, literaturë ndihmëse) janë bashkëkohore?

Aspak bashkëkohore	Pak bashkëkohore	Mesatarisht bashkëkohore	Shumë bashkëkohore	Jashtëzakonisht bashkëkohore
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)

Sa të larmishme dhe shumëllojshme janë materialet mësimore?

Aspak i larmishëm	Pak i larmishëm	Mesatarisht i larmishëm	Shumë e larmishme	Jashtëzakonisht i larmishëm
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)

Deri në çfarë mase përdoret teknologjia në procesin e të mësuarit?

Nuk përdoret	Përdoret rrallë	Ndonjëherë përdoret	Përdoret shpesh	Përdoret gjithmonë
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)

Sa shpesh përdoret interneti për qëllime mësimore?

Asnjëherë	Rrallë	Herë pas here	Shpesh	Gjithmonë
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)

3. VLERËSIMI I PEDAGOGUT NGA STUDENTËT

Si do të vlerësonit atmosferën që pedagogu krijon në auditor gjatë leksioneve/seminareve?

Shumë negative	Negative	Neutrale	Pozitive	Shumë pozitive
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)

Si do të vlerësonit përpikmërinë e pedagogut në mbajtjen e leksioneve/seminareve?

Shumë jo e përpiktë	Jo e përpiktë	Mesatare	E përpiktë	Shumë e përpiktë
①	②	③	④	⑤

Si do të vlerësonit korrektësinë e vlerësimit të studentëve nga pedagogu?

Jo korrekt në asnjë mënyrë	Jo shumë Korrekt	As korrekt as jo	Korrekt	Shumë Korrekt
①	②	③	④	⑤

4. VLERËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE NË INSTITUCIONIN ARSIMOR

Në cilin prej këtyre aspekteve pajtoheni që shërbimi i kërkuar merret në kohën e duhur? Zgjidh të gjitha që aplikohen.

Komunikimi dhe sjellja	Plotësimi i kërkesave të studentëve	Disponueshmëria në sekretari dhe bibliotekë	Auditorët, ndriçimi, mjetet mësimore, ngrohja, mjediset e jashtme	Akses në internet
Ⓐ	Ⓑ	Ⓒ	Ⓓ	Ⓔ

Në cilin prej këtyre aspekteve nuk pajtoheni që shërbimi i kërkuar merret në kohën e duhur? Zgjidh të gjitha që aplikohen.

Komunikimi dhe sjellja	Plotësimi i kërkesave të studentëve	Disponueshmëria në sekretari dhe bibliotekë	Auditorët, ndriçimi, mjetet mësimore, ngrohja, mjediset e jashtme	Akses në internet
Ⓐ	Ⓑ	Ⓒ	Ⓓ	Ⓔ

5. VLERËSIMI I BURIMEVE DHE SHËRBIMEVE NË BIBLIOTEKËN DHE LABORATORIN AKADEMIK

Cilat lloje të literaturës ju ndihmojnë më shumë në punën tuaj në bibliotekë ose laborator? (Zgjidh cilat aplikohen)

Libra	Artikuj shkencorë	Revista	Materiale online	Teza dhe punime diplome	Manuale dhe udhëzues
Ⓐ	Ⓑ	Ⓒ	Ⓓ	Ⓔ	Ⓕ

Sa plotësohen nevojat tuaja për zbatime praktike në laborator?

Aspak	Jo shumë	Mesatarisht	Në një masë të madhe	Plotësisht
①	②	③	④	⑤

Sa të disponueshme janë literaturat e pedagogëve në bibliotekë?

Kurrë të disponueshme	Rrallë të disponueshme	Ndonjëherë të disponueshme	Shpesh të disponueshme	Gjithmonë të disponueshme
①	②	③	④	⑤

6. MENDIME DHE VLERËSIME PËR ÇËSHTJE TË TJERA

A merrni njohuritë e nevojshme të zbatimeve praktike në institucionet pritëse dhe sa këto institucione ju ndihmojnë në aftësimin tuaj praktik:
Nëse keni komente dhe sugjerime për materialet mësimore, literaturën e përdorur, teknologjinë në mësimdhënies, infrastrukturën, laboratorët, cilësinë në shërbimet e ofruara, jepni mendimin tuaj:
Përmendim emra pedagogësh me performancë negative, që nuk japin vlerësimin e duhur (korrupsion):
Përmendim emra pedagogësh me performancë pozitive, pedagogët e preferuar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 415 prot

Korçë, më 26 / 02 / 2026

VENDIM

Nr. 90, datë 26.02.2026

PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR TË GJITHA PROGRAMET E
STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 18, pika 26, si dhe bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018, (I ndryshuar) pika 2.7. gërma a, Senati Akademik pasi diskutoi për propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore në lidhje me kuotat e pranimit për vitin akademik 2026-2027, për të gjitha programet e studimit, në mbledhjen e datës 26 .02.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit për të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2026-2027, bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit kuotat e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORË

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 416 prot

Korçë, më 26 / 02 / 2026

VENDIM

Nr. 91, datë 26.02.2026

PËR

MIRATIMIN E FORMAVE TË DIPLOMAVE DHE SUPLEMENTEVE TË
PROGRAMEVE TË REJA TË HAPURA/RIORGANIZUARA TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Në zbatim të nenit 91, pikës 3 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 70 pika 4, të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në Udhëzimin e MASR nr. 11, datë 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës" si edhe në udhëzimin e MASR nr.10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.02.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e formave të diplomave dhe suplementeve, për programet e reja të hapura/riorganizuara të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, sipas modelit bashkëlidhur, që janë:
 - "Diplomë Bachelor" në "Shkenca Politike".
 - "Diplomë Bachelor" në "Inxhinieri Informatike" (Program i përbashkët me Universitetin Politeknik të Tiranës)
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mesuesi në Shkencat Sociale"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mësuesi në Matematikë-Fizikë"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Statistikë e Aplikuar"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mesuesi në Biologji-Kimi"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mesuesi në Histori-Gjeografi"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mesuesi në Gjuhën Angleze"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mesuesi për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi"
 - "Diplomë Master i Shkencave" në "Mesuesi në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet"

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI**

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 417 prot

Korçë, më 26 / 02 / 2026

VENDIM

Nr. 92, datë 26.02.2026

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 33 pika 2, neni 38 pika 1, gërma c, si dhe në vendimin nr. 84, datë 25.02.2026 të Bordit të Administrimit, "Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.02.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 414 prot

Korçë, më 26 / 02 / 2026

VENDIM

Nr. 89, datë 26.02.2026

PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR NGRITJEN E FONDEVE DHE
PARTNERITETIT 2025-2030

Në mbështetje të nenit 37, pika 1 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 17, pika 1 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, me qëllim zhvillimin akademik dhe institucional të Universitetit, për të forcuar qëndrueshmërinë financiare të institucionit në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 26.02.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Strategjinë për ngritjen e fondeve dhe partneritetit 2025-2030", sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 101 prot

Korçë, më 16 / 01 / 2026

VENDIM

Nr. 18, datë 16 . 01 . 2026

PËR
PËRZGJEDHJEN E STUDENTËVE PËR FITUES PËR ÇDO PROGRAM
PRIORITAR QË OFRON UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË,
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Bazuar në nenet 37 e 38, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në pikën 6/1 të VKM-së nr. 386, datë 01.06.2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e tudentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 16.01.2026,

VENDOSI:

1. Përzgjedhjen e 5 studentëve përfitues për çdo program prioritar që ofron Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, për vitin akademik 2025-2026, sipas listës bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof. dr. Lofene Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

Lista e studentev e subjekt perfitimi sipas VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, te regjistruar ne vitin akademik 2025-2026.

Lloji i mbeshettes: Programe prioritare

Universitetin "Fan Noli", Kore.

Nr.	Emner	Atesi	Mbiemner	Fakulteti	Programi i studimit	Nota mesatare	Numri i Matrikullimit
1	Aleksandra	Dion	Deli	Shkencave te Natyres dhe Humane	Biologji - Kimi	8.58	K0421A140002
2	Arben	Agron	Mallari	Shkencave te Natyres dhe Humane	Matematike - Fizike	9.42	K0451A140003
3	Maria	Spiro	Buzo	Shkencave te Natyres dhe Humane	Biologji - Kimi	7.68	K0421A140005
4	Natle	Gençi	Neli	Shkencave te Natyres dhe Humane	Biologji - Kimi	6.77	K0421A140006
5	Nikolin	Romeo	Dhimitri	Shkencave te Natyres dhe Humane	Matematike - Fizike	9.32	K0451A140004



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 100 prot

Korçë, më 16 / 01 / 2026

VENDIM

Nr. 17, datë 16.01.2026

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.125, DATË
12.02.2025, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT PËR TË
GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI",
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027"**

Bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr.125, datë 12.02.2025, "Për miratimin e kritereve të pranimit për të gjitha programet e studimit të Universitetit "Fan S. Noli", për vitin akademik 2026-2027", si dhe shkresës nr. 8230 prot, date 19.12.2025, "Për publikimin e kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.01.2026,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë dy emërtime programesh studimi në tabelën bashkëngjitur vendimit të Senatit Akademik nr.125, datë 12.02.2025, "Për miratimin e kritereve të pranimit për të gjitha programet e studimit të Universitetit "Fan S. Noli", për vitin akademik 2026-2027".
2. Në tabelën e kritereve të pranimit për vitin akademik 2026-2027, qeliza ku është shënuar "Bachelor" në "Matematikë-Informatikë", do të shënohet "Bachelor" në "Data Science", kjo për arsye se ky program studimi është aplikuar për riorganizim.
3. Në tabelën e kritereve të pranimit për vitin akademik 2026-2027, qeliza ku është shënuar "Bachelor" në "Agroushqim", do të shënohet "Bachelor" në "Teknologji Ushqimore", kjo për arsye se ky program studimi është riorganizuar me urdhër të Ministrisë së Arsimit, nr. 263, date 17.06.2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI**

Prof. dr. Lorencë Ekonomi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 99 prot

Korçë, më 16 / 01 / 2026

VENDIM

Nr. 16, datë 16.01.2026

PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME DHE NUMRIN E
PERSONELIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË, NË TË
GJITHA NIVELET, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma ç), të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18, pika 5, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.01.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në të gjitha nivelet, për vitin 2026, sipas materialit bashkëngjitur.
2. T'i propozojë për miratim Bordit të Administrimit, strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në të gjitha nivelet, për vitin 2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof.dr. Lorenc Ekonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 46 Prot.

Korçë, më 08.01.2026

VENDIM

Nr. 7, datë 08.01.2026

PËR

MIRATIMIN E NDARJES SË GRANTIT BUXHETOR DHE DETAJIMIT TË
PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË KRIJUARA PËR VITIN 2026

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika “c”, Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “ Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, VKM-në Nr.75, datë 12.02.2018 “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Vendimi Nr. 01, date 05.01.2026, i AKFAL “Per Miratimin e perlllogaritjes se Grantit te Mesimdhënies per IAL”, “ Senati Akademik i Universitetit “Fan S. Noli”, në mbledhjen e datës 08 / 01 / 2025, pasi shqyroi kërkesen e Administratorit për miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit, detajimin e perdorimit te te ardhurave si dhe regjistrin e parashikimit te prokurimit publik për vitin 2026:

VENDOSI:

1. Miratimin e detajimit te perdorimit te te ardhurave dhe ndarjen e grantit buxhetor alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2026, grantit të mësimdhënies dhe grantit të mbështetjes studentore (bursave) si dhe limitet mujore.
2. Propozimin per miratim nga Bordi i Administrimit te Universitetit Fan S. Noli, Korce.

(Materiali përkatës bashkëngjitur këtij Vendimi)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI Prof. dr. Lorenc Ekonomi